



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 87 Prot.

Datë 30.07.2020

VENDIM

Nr. 08 , datë 30 . 07 .2020

PËR
MIRATIMIN E MASAVE PËRMIRËSUESE QË REZULTOJNË NGA ANALIZA E
SHKAQEVE QË KANË KRIJUAR GJETJET E KLSH-SË

Bazuar në nenin 6, gërma “e” e Ligjit Nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, Vendimin nr.183, datë 31.12.2019 dhe Raportin Përfundimtar “Mbi auditimin e ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil në bazë të programit të auditimit Nr. 600/1, datë 09.09.2019”, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të miratojë masat përmirësuese që rezultojnë nga analiza e shkaqeve që kanë krijuar gjetjet të cilat KLSH i ka adresuara për trajtim te Këshilli Drejtues, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Strukturat përkatëse në institucion të zbatojnë këto masa në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që, në vendimmarrjet e ardhshme, të shmangen parregullësi të mundshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES
Dritan Gjonbalaj